

VENDIM
PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR,
SEKUESTRO PREVENTIVE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga:

GJYQTAR: ERVIN POLLOZHANI

asistuar prej sekretares gjyqësore **Lusjana Idrizi**, në Tiranë sot më datë **06. 09. 2016**, mori në shqyrtim materialin procedures me **Nr. 1146 Akti**, që i përket:

KERKUES:

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, perfaqesuar nga prokurori me autorizim Armand Gurakuqi.

OBJEKTI:

Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me Nr. 2...1, ne emer te shoqerise "A" sh.p.k. me administrator dhe ortak shtetasin R. Sh, llogari kjo prane bankes "Intesa San Paolo Bank" sh.a.

BAZA LIGJORE:

Nenet 228, 229, 274 te K. Pr. Penale.

Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi kërkesën e prokurorit i cili kërkoi: *Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me Nr. 2...1, ne emer te shoqerise "A" sh.p.k. me administrator dhe ortak shtetasin R. Sh, llogari kjo prane bankes "Intesa San Paolo Bank" sh.a. dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,*

VËREN :

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane ka paraqitur per gjykim kerkesen penale me objekt "*Caktim i mases se sigurimit pasuror sekuestro preventive ne kuader te procedimit penal Nr. 6550, dt. 05. 09. 2016. Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me Nr. 2...1, ne emer te shoqerise "A" sh.p.k. me administrator dhe ortak shtetasin R. Sh, llogari kjo prane bankes "Intesa San Paolo Bank" sh.a.*"

Nga analiza e provave te lejuara per shqyrtim rezultoi se, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Gjyqësor Tirane ka regjistruar

procedimin penal Nr. 6550, date 05. 09. 2016 per veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose aktiviteteve kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga permbajtja e akteve të çështjes rezulton se nga ana e Seksionit për Pastrimin e Parave pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë janë grumbulluar të dhëna që krijojnë dyshime për një rast pastrimi parash nga ana e shtetasit R. Sh i dtl. 15. 05. 19.. si dhe shtetasit rus B. I. W/W i dtl. 11. 03. 19...

Nga të dhënat e siguruara konstatohet se shtetasi R. Sh ka regjistruar në dt. 13. 11. 2014 aktivitetin e tij të biznesit në kuadër të shoqërisë "A... .. U" me NIPT L 4...5 S me adresë Bulevardi "... ..", Tiranë, në të cilën ky shtetas është administrator dhe ortak i vetëm i saj në masën 100% të kuotave. Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është "turizëm mjekësor dhe transplant organesh...". Rezulton se kjo shoqëri ka çelur llogari në dt. 09. 12. 2014 në monedhat Lek, Euro dhe USD në të cilat janë kryer transaksione të ndryshme për persona të ndryshëm përfshirë edhe shtetasin rus të dyshuar për trafikim organesh B. V.. Nga monitorimi i vazhdueshëm që u është bërë llogarive të kësaj shoqërie nga organet e ngarkuara, rezulton se në llogarinë e shoqërisë "... .. U" sh.p.k. me numer 2...1 pranë Bankës "Intesa San Paolo Bank" ka mbërritur një transfer të vlerën prej 40, 957 USD me përshkrimin "fatura 2001 shërbime mjekësore" nga shteti i Izraelit. Po kështu transaksione rezultojë të jenë kryer edhe me shtetasin R. M. i cili rezulton se në muajin janar 2010 është ndaluar nga autoritetet italiane në Pescara si pjesë e një bande që trafikonte lëndë narkotike.

Nga të dhënat e siguruara rezulton se shtetasi B. I. V. është i përfshirë në transplantimin ilegal të organeve. Nga verifikimet e bëra ky shtetas ka llogari bankare në bankën "Raiffeisen Bank" sh.a. në emër të kompanive që ai zoteron, konkretisht shoqëritë "J..." dhe "A... I... G...".

Nisur nga të dhënat e siguruara, konkretisht përfshirja e shtetasit R. Sh në transaksione me shtetasit e tjerë e për të cilët ka të dhëna në përfshirjen e tyre në aktivitete të jashtëligjshme si shtetasi B. V, i dyshuar si trafikant organesh dhe shtetasi R. M. i arrestuar si pjesë e një bande të trafikimit të lëndëve narkotike, atëherë ka dyshime të bazuara në prova se pasuria e luajtur në emër të shtetasit R. Sh konkretisht shumat e depozituara dhe të transferuara në llogaritë e shoqërisë "... .. U" sh.p.k. që administrohet prej tij pranë "Intesa San Paolo Bank" sh.p.k. janë rezultat i këtij aktiviteti kriminal.

Për këto arsye kërkohet vendosja e sekuestros preventive mbi këte llogari bankare konform Nenit 274/2 të K. Pr. Penale me qëllim pengimin e disponimit të lire të saj, fakt që mund të zjaste ose rendonte pasojat e veprës

penale "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteve kriminale" qe aktualisht eshte duke u hetuar nga organi i akuzes ne kuader te procedimit penal 6550 te vitit 2016.

Gjykata nga ana e saj, pasi mori ne shqyrtim kerkesen ne raport me dispozitat procedurale penale dhe provat e lejuara per shqyrtim vendos pranimi e saj si te bazuar ne ligj.

Neni 274 dhe 276 te K. Pr. Penale percaktojne se : *"Kur ka rrezik qe disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose zjase pasojat e saj ose te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale me kerkesen e prokurorit gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tyre me vendim te arsyetuar.*

2. *Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe cdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet sipas nenit 36 te Kodit Penal.*

3. *Kur ndryshojne kushtet e zbatimit gjykata me kerkese te prokurorit ose te interesuarit e heq sekuestron (neni 274)*

"1.Kunder vendimit per venien ose mosvenien e sekuestros cildo qe ka interes mund te beje ankim.

2.Kerkesa e ankimit mund te paraqitet brenda 10 diteve nga dhenia e vendimit ose nga dita kur i interesuari ka marre dijene per sekuestron e vene...."

Sekuestro preventive eshte mase sigurimi pasurore qe aplikohet ne rastet kur ka arsye te dyshohet se disponimi i lire i nje sendi qe lidhet me vepren penale rendon ose zgjate pasojat e saj ose mund te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale. Vendosja e sekuestros ne kete rast pengon perdorimin dhe qarkullimin e lire te sendeve qe lidhen me vepren penale duke garantuar ne kete menyre nevojat e sigurimit. Sekuestrimi vendoset mbi çdo lloj pasurie qe lejohet te konfiskohet ne baze te nenit 36 te Kodit Penal ku perfshihen dhe produktet e vepres penale (*Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit b) te produkteve te vepres penale, ku perfshihet cdo lloj pasurie....*).

Nga provat e nenshttruara shqyrtimit gjyqesor rezulton se organi i akuzes ka nisur procedimin penal per vepren penale te *"Pastrimit te produkteve te vepres penale"* dhe ekzistojne prova te mjaftueshme per te krijuar dyshimin e arsyeshem se kjo veper mund te jete konsumuar nga personi nen hetim R. Sh (administratori i shoqerise) ne bashkepunim me shtetasin rus B. I. W/W si dhe shtetasin shqiptar R. M..

Nga te dhenat e siguruara nga organi i akuzes rezulton se shtetasi Renato Mezini ka qene i ndaluar ne Itali per perfshirje ne aktivite kriminale te lidhura me trafikun e lendeve narkotike. Nisur nga ky aktivitet kriminal, trasanksionet ne vlerat monetare te kryera me te ne banka te nivelit te dyte, te cilat nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike pasi nuk identifikohen burimet e ligjshme te te ardhurave krijone dyshimin e arsyeshem te bazuar ne prova se burimi i krijimit te pasurise jane te ardhura te siguruara nga aktiviteti kriminal.

Po keshtu nga te dhenat e siguruara nga organi i akuzes rezulton se shtetasi rus B. I. W/W eshte i perfshire ne transplantimin ilegal te organeve. Nisur nga ky aktivitet kriminal, trasanksionet ne vlerat monetare te kryera me te ne banka te nivelit te dyte, te cilat nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike pasi nuk identifikohen burimet e ligjshme te te ardhurave krijone dyshimin e arsyeshem te bazuar ne prova se burimi i krijimit te pasurise jane te ardhura te siguruara nga aktiviteti kriminal.

Ne rastin objekt gjykimi ka dyshime te bazuara ne prova se pasuria e luajtshme ne emer te shoqerise "... ..U" sh.p.k. me ortak te vetem shtetasin R. Sh dhe konkretisht shuma prej 40, 957 USD Euro e depozituar ne llogarine e kesaj shoqerie me Nr. 2...1 prane bankes "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a eshte krijuar mbi bazen e te ardhurave te siguruara nga veprat penale ne fushen e tregtimit dhe trafikimit te organeve te transplantuara. Nisur nga aktiviteti kriminal i te dyshuarit, transaksionet me shtetas te dyshuar si autor veprash penale, transferata bankare ne shuma te ndryshme, faktit qe keto te ardhura nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike sepse nuk identifikohen burimet e ligjshme si edhe faktit qe sigurimi ose krijimi i ketyre te ardhurave eshte pas periudhes se dyshuar kriminale, krijohet dyshimi i arsyeshem dhe i bazuar ne prova se burimi i kesaj pasurie (llogari bankare) jane te ardhurat e siguruara nga aktiviteti kriminal i shoqerise "... ..U" sh.p.k. me ortak te vetem shtetasin R. Sh dhe se eshte e nevojshme te zbatohet masa e sigurimit "sekuestro preventive" mbi llogarine bankare me Nr. 2...1 prane bankes "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a. qe kjo shoqeri ka te hapur prane saj, kjo ne baze te nenit 274 te K. Pr. Penale. Kjo mase cmohet e nevojshme per te shmanguar qarkullimin e metejshem civil te produktit te vepres penale, i cili rrezikon te transformohet ose shnderrohet ne pasuri te tjera, duke renduar e zjatur me tej pasojat e vepres penale.

PER KETO ARSYE :

Gjykata. bazuar në Nenet 274 e vijues të K. Pr. Penale,

VENDOSI :

- 1- Pranimin e kerkeses.
2. Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me Nr. 2...1 e hapur prane bankes "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a. ne emer te shoqerise "... ..U" sh.p.k. me administrator dhe ortak te vetem shtetasin R. Sh i dtl. 15. 05. 19...
3. Ngarkohen oficeret e policise gjyqesore per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.
4. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve afat ky qe fillon nga shpallja e vendimit. Per subjektet e interesuara ky afat fillon nga dita e venies ne dijeni te sekuestros.
- 5. U shpall sot me dt. 06. 09. 2016, ne Tirane.**

SEKRETARE

LUSJANA IDRIZI

GJYQTAR

ERVIN POLLOZHANI